

DEPARTAMENTI I SHTETIT I SHBA
BYROJA PËR DEMOKRACINË, TË DREJTAT E NJERIUT DHE PUNËN
RAPORTET PËR VENDET LIDHUR ME PRAKTIKAT PËR TË DREJTAT E NJERIUT
PËR VITIN 2017
SHQIPËRIA

Republika e Shqipërisë është një demokraci parlamentare. Kushtetuta ia jep autoritetin legjislativ parlamentit (kuvendit) me një dhomë, i cili zgjedh si kryeministrin ashtu edhe presidentin. Kryeministri drejton qeverinë, ndërkohë që presidenti ka pushtet të kufizuar ekzekutiv. Më 25 qershor, vendi zhvilloi zgjedhje parlamentare. Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE) raportoi se zgjedhjet respektuan liritë themelore, por u ndikuan negativisht nga pretendimet për blerje votash dhe presion ndaj votuesve.

Autoritetet civile ruajtën kontroll efektiv mbi forcat e sigurisë.

Çështjet më domethënëse të të drejtave të njeriut përfshinin kufizimin e lirisë së shprehjes dhe shtypit, përfshi vetëcensurën dhe frikësimin e gazetarëve, nxitur nga interesa financiare dhe politike; si dhe korrupsioni i përhapur gjerësisht në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Pandëshkueshmëria mbeti problem. Ndjekja penale dhe sidomos dënimi i zyrtarëve që kryenin abuzime ishte sporadik dhe jokonseguent. Zyrtarët, politikanët, gjyqtarët si dhe personat me interesa të fuqishme biznesi shpesh ia dilnin të shmangnin ndjekjen penale. Autoritetet morën masa teknike, të tilla si pagesa elektronike të gjobave të trafikut si dhe kamerat e trupit, për të përmirësuar llogaridhënien e policisë si dhe ndëshkuan disa zyrtarë të niveleve të ulëta për abuzime.

Seksioni 1. Respekti për Integritetin e Personit, përfshi Lirinë nga:

a. Privimi Arbitrar i Jetës dhe Vrasje të Tjera të Jashtëligjshme apo me Motive Politike

Nuk pati raportime se qeveria apo agjentët e saj kryen vrasje arbitrare apo të jashtëligjshme.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje nga apo në emër të autoriteteve të qeverisë.

c. Tortura dhe Trajtime të Tjera e Ndëshkime të Egra, Çnjerëzore apo Degraduese

Ndërkohë që kushtetuta dhe ligji i ndalojnë veprime të tilla policia dhe rojet e burgjeve herëherës rrahën dhe abuzuan me të dyshuarit dhe të burgosurit. Deri në shtator, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat mori ankime për abuzim dhe korrupsion të policisë që çoi në sanksione administrative dhe ndjekje penale. Deri në korrik, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) raportoi një rast të dhunës së pretenduar fizike në një ambient të policisë.

Avokati i Popullit raportoi se shumica e rasteve të pretenduara të abuzimit fizik apo psikologjik ndodhën gjatë arrestimit dhe marrjes në pyetje. Deri në gusht, Avokati i Popullit mori 104 ankesa nga të ndaluarit. Shumica e ankesave lidhej me cilësinë e kujdesit shëndetësor. Avokati i Popullit nuk referoi ndonjë rast për ndjekje penale.

Kushtet në Burgje dhe Qendra Paraburgimi

Kushtet e këqia fizike dhe mungesa e trajtimit mjekësor, sidomos për çështje të shëndetit mendor, ishin probleme serioze, siç ishin mjediset e mbipopulluara dhe korrupsioni. KSHH dhe avokati i popullit raportuan se kushtet në qendra paraburgimi të caktuara ishin aq të këqia sa përbënin trajtim çnjerëzor. Kushtet mbetën nën standarde në mjediset e ndalimit të policisë jashtë Tiranës dhe qendrave të tjera kryesore urbane.

Kushtet Fizike: Qeveria, avokati i popullit dhe KSHH raportuan se mbipopullimi në burgje vazhdoi dhe se popullsia e burgjeve ishte 3-5 përqind më e madhe se sa kapaciteti i planifikuar i mjediseve të burgjeve. Mbipopullimi ishte më keq në qendrat e paraburgimit. Kushtet në burgje dhe qendra paraburgimi për femrat ishin përgjithësisht më të mira se sa në ato për meshkujt.

Shumica e 104 ankesave të marra nga avokati i popullit nga të burgosurit deri në gusht kishin të bënin me cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Të burgosurit ankoheshin edhe për aksesin në programet e lejes së posaçme, vonesa në zbatimin e urdhrave të transferimit në burgje, si dhe transferimet e padëshiruara në burgje të tjera. KSHH po ashtu raportoi ankesa të shumta lidhur me cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe transferimin/mostransferimin midis qendrave të paraburgimit. Në disa raste, zyrtarët e burgjeve vendosnin të dënuarit që nuk kishin masa disiplinore në qeli izolimi për shkak të mungesës së hapësirës për popullsinë e përgjithshme të burgjeve. Avokati i popullit dhe organizatat joqeveritare (OJQ-të) raportuan se autoritetet mbanin të burgosurit me paaftësi mendore në burgjet noramle, ku aksesin në kujdesin shëndetësor mendor ishte shumë i pamjaftueshëm.

Kushtet në burgje dhe qendra paraburgimi varionin shumë sipas vjetërsisë dhe llojit të mjedisit. Avokati i popullit, KSHH dhe Qendra Shqiptare e Rehabilitimit nga Trauma dhe Tortura identifikuan probleme si në strukturat e reja ashtu edhe të vjetra, të tilla si lagështira në qeli, higjiena e keqe, mungesa e shtresave për krevate, si dhe furnizimi i çrregullt me ujë dhe energji.

Kushtet në mjediset e administruara nga Ministria e Brendshme, të tilla si stacione policie dhe mjedise ndalimi të përkohshëm, ishin të pamjaftueshme, përveç mjediseve rajonale në Tiranë, Gjirokastër, Kukës, Fier dhe Korçë. Disa mjedise paraburgimi ishin pa ngrohje gjatë dimrit, dhe në disa mungonin kushtet bazë të higjenës, të tilla si dushe dhe lavamanë. Mjediset ishin të mbipopulluara, me akses të kufizuar në banjë dhe kishin pak ose aspak ajrosje, dritë natyrore, apo krevatë dhe stola. Sistemet e monitorimit me kamera nuk ekzistonin ose ishin të pamjaftueshme në shumicën e stacioneve të policisë.

Administrimi: Ministria e Drejtësisë administronte burgjet e vendit. Avokati i popullit raportoi se zyrtarët të burgjeve dhe policisë përgjithësisht bashkëpunonin në hetime. OJQ-të dhe avokati i popullit vërejtën regjistra të paplotësuar si duhet në disa institucione, sidomos në stacione policie të vogla apo rurale.

Korrupsioni vazhdoi të ishte një problem serioz në qendrat e paraburgimit, sidomos në lidhje me aksesin në punë dhe programet e lejeve të posaçme. OJQ-të raportuan se personat e përfshirë në programe pune merrnin vetëm 90 Lekë (rreth \$0.80) në muaj dhe nuk merrnin kredite për sigurimet shoqërore. Në korrik 2016, zëvendës drejtori i përgjithshëm i burgjeve, Iljaz Labi, u arrestua për përfshirjen e tij në krijimin e dokumenteve të rreme të prokurimit për kompanitë që furnizonin ushqime. Në shkurt, policia arrestoi për akuza të ngjashme korrupsioni ish-

drejtorin e përgjithshëm të burgjeve, Artur Zoto, i cili kishte dhënë dorëheqjen vullnetarisht pak ditë pas arrestimit të Labit. Gjatë vitit, persona të personelit të lartë drejtues të burgjeve u arrestuan dhe dënuan për furnizimin me drogë të të burgosurve ose sepse kërkonin para për të lejuar vizita të familjarëve.

Shumica e drejtorëve të burgjeve në vend u shkarkuan gjatë vitit për shkak të korrupsionit, abuzimit të detyrës, dhe të tjera shkelje të ligjit.

Monitorimi i Pavarur: Qeveria lejoi grupe vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, median si dhe organe ndërkombëtare të tilla si Komiteti për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Europës për të monitoruar kushtet e burgjeve. Avokati i popullit kreu inspektime të shpeshta të palajmëruara të mjediseve të paraburgimit.

Përmirësime: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve deklaroi se deri në korrik, mbipopullimi i përgjithshëm i burgjeve ishte ulur nga 9 përqind në vitin 2016 në 3 përqind. Si avokati i popullit ashtu edhe OJQ-të raportuan një ulje në rastet e abuzimit fizik dhe psikologjik në krahasim me vitin e mëparshëm.

d. Arrestimi apo Ndalimi Arbitrar

Ligji dhe kushtetuta ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe qeveria në përgjithësi i respektoi këto.

ROLI I POLICISË DHE APARATIT TË SIGURISË

Ministria e Brendshme mbikqyr Gardën e Republikës dhe Policinë e Shtetit, e cila përfshin Policinë e Kufirit dhe Migracionit. Policia e Shtetit është përgjegjëse në radhë të parë për sigurinë e brendshme. Garda e Republikës mbron zyrtarët e lartë shtetërorë, personalitetet e huaja, si dhe prona të caktuara shtetërore. Ministria e Mbrojtjes mbikqyr forcat e armatosura, të cilat ndihmojnë popullsinë në raste nevojash humanitare. Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) mbledh informacion, kryen zbulim dhe kundërzbulim dhe përgjigjet përpara kryeministrit.

Autoritetet civile përgjithësisht ruajtën kontroll efektiv mbi policinë, Gardën e Republikës, forcat e armatosura dhe SHISH, edhe pse zyrtarët përdornin periodikisht burimet shtetërore për përfitime personale dhe anëtarë të forcave të sigurisë kryenin abuzime.

Policia nuk e zbatonte ligjin gjithmonë në mënyrë të barabartë. Lidhjet personale, lidhjet politike apo kriminale, infrastruktura e dobët, mungesa e pajisjeve, apo mbikqyrja joadekuate shpesh ndikonin zbatimin e ligjit. Udhëheqësia e dobët dhe mungesa e diversitetit në forcat policore kontribuonin në vazhdimin e korrupsionit dhe sjelljes joprofesionale. Autoritetet vazhduan të bënin përpjekje për t'i trajtuar këto problem duke rinovuar mjediset e policisë, duke përmirësuar automjetet dhe duke theksuar publikisht masat anti-korrupsion.

Pandëshkueshmëria mbeti një problem serioz, edhe pse qeveria bëri përpjekje më të mëdha për ta trajtuar atë, sidomos duke rritur përdorimin e provave të kamerave për të dokumentuar ndjekur penalisht shkeljet në sjelljen e policisë.

Ndërkohë që qeveria kishte mekanizma për të hetuar dhe ndëshkuar abuzimet dhe korrupsionin, korrupsioni në polici mbeti problem. Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave mori 3,811 ankesa me telefon nëpërmjet “linjës së gjelbër” anti-korrupsion deri në 31 korrik. Shumica e ankesave kishin të bënin me “mosveprim nga oficerët e policisë,” “gjobë të padrejtë,” apo “shkelje të procedurave standarde të punës.” Zyra nxori 43 shkelje administrative, duke rekomanduar procedim disiplinor për 57 oficerë policie. Rastet e pesë oficerëve iu dërguan prokurorisë. Gjatë vitit, edhe avokati i popullit trajtoi ankesa kundër oficerëve të policisë, kryesisht në lidhje me problemet me arrestimet dhe ndalimin.

PROCEDURAT E ARRESTIMIT DHE TRAJTIMI I TË NDALUARVE

Ligji kërkon që, përveç arrestimeve të kryera gjatë kryerjes së një krimi, policia mund të arrestojë një të dyshuar për arsye penale vetëm me një kërkesë të nxjerrë nga një gjykatës dhe bazuar në prova të mjaftueshme. Nuk pati raportime për arrestime të fshehta. Me ligj, policia duhet të informojë menjëherë prokurorin për një arrestim. Prokurori mund ta lirojë të dyshuarin ose t’i drejtohet gjykatës brenda 48 orësh për ta mbajtur individin më gjatë. Gjykata duhet të vendosë brenda 48 orësh nëse do ta vendosë të dyshuarin në paraburgim, të kërkojë garanci, të ndalojë udhëtimin, apo të kërkojë paraqitjen e të pandehurit rregullisht përpara policisë. Prokurorët kërkonin dhe gjykatat urdhëronin ndalimin në shumë çështje penale, edhe pse gjykatat hera-herës i refuzonin kërkesat e prokurorëve për ndalimin e të pandehurve me lidhje të forta dhe profil të lartë.

Kushtetuta kërkon që autoritetet të informojnë personat e ndaluar menjëherë për akuzat kundër tyre si dhe të drejtat e tyre. Autoritetet ligjzbatuese nuk e respektuan gjithmonë këtë kërkesë. Amendamentet në Kodin e Procedurës Penale që hynë në fuqi në 1 gusht impononin detyrime shtesë për ligjzbatuesit që në lidhje me të drejtat e të pandehurve dhe personave të ndaluar. Të njëjtat amendamente përcaktonin një sistem të ri për trajtimin e aspekteve monetare të garancisë. Gjykatat shpesh urdhëronin të dyshuarit të paraqiteshin një herë në javë përpara policisë apo prokurorit. Ndërkohë që ligji iu jep të ndaluarve të drejtën për akses të menjëhershëm në një avokat, nëse është e nevojshme mbuluar me para publike, OJQ-të raportuan marrje në pyetje shpesh pa praninë e një avokati. Autoritetet i vendosën shumë të dyshuar në arrest shtëpie, shpesh me kërkesën e tyre, sepse nëse dënoheshin iu llogaritej koha e kryer.

Sipas ligjit, policia duhet t’i transferojë të ndaluarit nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka mjedise më të përshtatshme për ndalimet afatgjata, nëse ndalimi i tyre i kalon 10 orët. Për shkak të mbipopullimit në sistemin penitenciar, të ndaluarit, përfshi minorenët, zakonisht qëndronin në qendrat e paraburgimit të policisë për kohë të gjatë.

Arrestimi Arbitrar: Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar. Ndonëse qeveria përgjithësisht i respektoi këto ndalime, pati raste kur policia ndaloi persona për marrje në pyetje për periudha tepër të gjata pa i arrestuar ata formalisht.

Paraburgimi: Ndërkohë që ligji kërkon përfundimin e shumicës së hetimeve përpara gjyqit brenda tre muajsh, prokurori mund ta zgjasë këtë periudhë deri në dy vite ose më gjatë. Ligji mundëson që ndalimi në paraburgim nuk duhet të kalojë tre vjet; qeveria raportoi pesë raste të ndalimeve para gjyqit që e kapërcyen këtë kufi. Ndalimi i zgjatur në paraburgim shpesh ndodhte për shkak të hetimeve të vonuara, gabimeve të mbrojtjes, apo mosparaqitjes së qëllim të

avokatit mbrojtës. Amendamentet në KPP që hynë në fuqi gjatë vitit përfshinin dispozita që synonin t'i jepnin fund pamundësisë ekzistuese të gjyqtarëve për të parandaluar veprime të tilla vonuese duke disiplinuar avokatin përgjegjës për fyerjen e autoritetit të gjykatës. Burimet e kufizuara materiale, mungesa e hapësirës, menaxhimi i dobët i kalendarit të gjykatës, personeli i pamjaftueshëm, dhe mosparaqitja e avokatëve dhe dëshmitarëve nuk e lejuan sistemin e gjykatave të gjykonte çështjet në kohë. Deri në shtator, 44 përqind e popullsisë së burgjeve dhe qendrave të paraburgimit ishin në paraburgim.

Aftësia e të Ndaluarit për të Apeluar Ligjshmërinë e Ndalimit përpara Gjykatës: KPP kërkon që gjykata të shqyrtojë nevojën e ndalimit brenda tri ditësh. Nëse ndalimi nuk revokohet, i ndaluari mund të apelojë në Gjykatën e Lartë. Nëse nuk merret vendim brenda një periudhe të caktuar, ndalimi bëhet i pavlefshëm. KPP po ashtu kërkon që prokurori t'i paraqesë gjykatës përditësime një here në dy muaj lidhur me informacion të siguruar pas ndalimit. Gjyqtari mund ta revokojë ndalimin bazuar në informacionin e ri.

e. Mohimi i Gjyqit të Drejtë Publik

Edhe pse kushtetuta siguron një gjyqësor të pavarur, presioni politik, frikësimi, korrupsioni i përhapur gjerësisht si dhe burimet e kufizuara hera-herës e penguan gjyqësorin të funksiononte në mënyrë të pavarur dhe eficiente. Seancat gjyqësore shpesh nuk ishin të hapura për publikun. Oficerët e sigurisë në gjykata shpesh refuzonin të lejonin vëzhgues në seanca dhe në mënyrë rutinë i telefononin gjyqtarit kryesues për të pyetur nëse duhej lejuar një individ që kërkonte të ndiqte një seancë të caktuar. Disa agjenci demonstronin një zakon injorimi të urdhrave të gjykatës. Politizimi i emërimeve për në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese kërcënonte të minonte pavarësinë dhe integritetin e këtyre institucioneve. Deri në tetor, në Gjykatën e Lartë kisthe dhjetë vende bosh ndërkohë që gjykata përballej me një numër të konsiderueshëm çështjesh të prapambetura.

Ministria e Drejtësisë përgjithësisht nuk ndiqte në mënyrë energjike masat disiplinore ndaj gjyqtarëve. Kur e bënte këtë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) hezitonte t'i zbatonte këto masa. Gjatë vitit 2016, Ministria e Drejtësisë inicioi procedim disiplinor kundër nëntë gjyqtarëve. Në të njëjtin vit, KLD shkarkoi një gjyqtare pasi ajo u dënua për korrupsion dhe u transferua në një gjykatë tjetër. Gjatë vitit, Ministria e Drejtësisë nuk ndoqi veprime disiplinore kundër gjyqtarëve gjatë hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri për organizimin e drejtësisë dhe KLD nuk mori vendim për ndonjë kërkesë pezull. KLD urdhëroi pezullimin e një gjykatësi të shkallës së parë pas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda. Çështja vazhdoi në fund të vitit.

PROCEDURAT E GJYQIT

Ligji prezumon që të pandehurit janë të pafajshëm deri sa të dënohen. Ligji siguron që të pandehurit të informohen menjëherë dhe hollësisht për akuzat kundër tyre, me përkthim falas sipas nevojës, si dhe që të kenë një gjyq të drejtë dhe publik pa vonesa të panevojshme. Të pandehurit kanë të drejtën të jenë të pranishëm në gjyqin e tyre, të konsultohen me një avokat dhe t'u ofrohet një i tillë me shpenzime publike nëse nuk mund ta përballojnë. Ligji iu ofron të pandehurve kohën dhe mjedisin e përshtatshëm për të përgatitur mbrojtjen dhe akses në përkthim falas. Të pandehurit kanë të drejtën të përballen me dëshmitarët kundër tyre dhe të paraqesin dëshmitarë dhe prova në mbrojtje të tyre. Të pandehurit nuk mund të detyrohen të dëshmojnë apo pranojnë fajin. Të pandehurit kanë të drejtën të apelojnë. Qeveria përgjithësisht

i respektoi këto të drejta, ndonëse gjyqet nuk ishin gjithmonë publike dhe aksesin në një avokat ishte ndonjëherë problematik. Pas hyrjes në fuqi të amendamenteve të KPP, prokurori duhet të aplikojë përpara një gjykatësi në një seancë paraprake për ta dërguar çështjen në gjyq. Reforma synonte të ishte një garanci më shumë për të drejtat e të pandehurve dhe aksesin e tyre tek provat kundër tyre.

TË BURGOSUR DHE TË NDALUAR POLITIKË

Nuk pati raportime për të burgosur apo të ndaluar politikë.

PROCEDURAT GJYQËSORE CIVILE DHE KOMPENSIMET

Ndërkohë që individët dhe organizatat mund të kërkojnë korrigjim të shkeljeve të të drejtave të njeriut, gjykatat ishin të prekshme nga korrupsioni, ineficienca, frikësimi dhe ndërhyrjet politike. Gjykatësit i zhvillonin shumë prej seancave gjyqësore në zyrat e tyre, duke demonstruar një mungesë profesionalizmi dhe duke ofruar mundësi për korrupsion. Këta faktorë minonin autoritetin e gjyqësorit, kontribuonin për vendime të debatueshme gjyqësore, dhe çonin në aplikim jokonseguent të ligjit. Pavarësisht të drejtës statutoare për ndihmë ligjore falas në çështjet civile, OJQ-të raportuan se shumë pak individë përfituan nga kjo gjatë vitit.

Personat që kanë shterruar mundësitë në gjykatat e vendit mund të apelonin në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Në shumë raste, autoritetet nuk i vinin në zbatim vendimet e GJEDNJ, sidomos ato që lidheshin me të drejtën për një gjyq të drejtë.

Personat që kishin qenë të burgosur politikë gjatë ish-sistemit komunist vazhdonin të kërkonin kompensim nga qeveria. Në disa raste, grupe ish-të burgosurish politikë protestuan dështimin e qeverisë për t'i paguar atyre kompensimin e mandatuar nga ligji. Qeveria bëri njëfarë përparimi për të disburuar kompensim gjatë vitit. Deri në qershor, qeveria kishte paguar këstin e tetë dhe të fundit për ish-të burgosurit politikë që ishin ende gjallë. Qeveria po ashtu ra dakord të përfshinte 320 ish-të burgosur politikë që nuk kishin paraqitur dokumentacionin e tyre në kohë për të përfituar nga kompensimi.

KTHIMI I PRONAVE

Mijëra pretendime për prona private dhe fetare të konfiskuara gjatë kohës së komunizmit mbetën të pazgjidhura nga Agjencia për Trajtimin e Pronave e qeverisë. Avokati i popullit raportoi se deri më sot, qeveria nuk kishte ekzekutuar ende 26,000 vendime gjykatash dhe as nuk kishte shqyrtuar 11,000 pretendime që lidheshin me të drejtën e pronës. Pretenduesit mund t'i apelojnë çështjet në GJEDNJ dhe gjatë vitit, qindar çështje – shumë prej tyre të lidhura me pronën – prisnin shqyrtim nga GJEDNJ.

Shqipëria përqafoi Deklaratën Terezin në vitin 2009 dhe Udhëzimet dhe Praktikat e Mira në vitin 2010. Shqipëria nuk ka ndonjë ligj për kthim dhe kompensim lidhur me konfiskimet e pronave private të lidhura me epokën e Holokaustit. Sipas ligjit, komunitetet fetare kanë të njëjtat të drejta kthimi dhe kompensimi pronash si personat fizikë dhe juridikë. Nga koha kur nënshkroi Deklaratën Terezin në vitin 2009, Shqipëria nuk ka miratuar ndonjë ligj që lidhet me kthimin e pronave pa trashëgimtarë. Qeveria nuk raportoi pretendime pronash paraqitur nga viktimat të Holokaustit.

f. Ndërhyrjet Arbitrare apo të Jashtëligjshme të Privatësisë, Familjes, Banesës apo Korrespondencës

Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit (IKMT) shkatërroi disa banesa pa një proces të drejtë ligjor si pjesë e një fushate më të gjerë për të shkatërruar ndërtime të ndërtuara në mënyrë të paligjshme. Deri në korrik, avokati i popullit mori shtatë ankesa nga qytetarët kundër inspektorateve vendore dhe trek under IKMT, përfshi për dështimin për të paraqitur paralajmërim të mjaftueshëm me shkrim, dështimin për të shqyrtuar aplikimin e një pronari banese për legalizimin e pronës dhe për mungesë transparence.

Gjatë gjithë vitit, banorë të rajonit të Himarës vazhduan të ankoheshin për ashpërsi të shënjestruar nga qeveria që çoi në shkatërrimin e pjesshëm apo të plotë të shumë shtëpive dhe bizneseve me paralajmërim të shkurtër dhe pa rekurs ligjor për kompensim të përshtatshëm. Në tetor, qeveria shkatërroi disa struktura të pabanuara në Himarë teksa zbatonte një plan zhvillimi urban për të cilin banorët u ankuan se nuk ishin konsultuar si e sa duhet nga autoritetet bashkiake. Shkatërrimi i 12 strukturave të tjera u ndalua sepse banorët paraqitën një çështje në gjyq kundër autoriteteve. Autoritetet bashkiake i mbrojtën shkatërrimet si të nevojshme për zhvillimin komercial.

Seksioni 2. Respekti për Liritë Civile, Përfshi:

a. Lirinë e Shprehjes, Përfshi të Shtypit

Kushtetuta siguron lirinë e shprehjes, përfshi për shtypin, dhe qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta. Pati raportime se qeveria, bizneset, dhe grupet kriminale u përpoqën të ndikonin median në mënyra të papërshtatshme.

Liria e Shtypit dhe Medias: Media e pavarur ishte aktive dhe shprehte shumëllojshmëri pikëpamjesh, ndonëse kishte disa përpjekje për të ushtruar trysni të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë politike dhe ekonomike mbi median, përfshi kërcënimet dhe dhunën ndaj gazetarëve që përpqeshin të investigonin lajme për krimin dhe korrupsionin. Trysnia politike, korrupsioni dhe mungesa e fondeve kufizuan shtypin e shkruar të pavarur, dhe gazetarët sipas raportimeve praktikonin vetëcensurën. Mungesa e sigurisë ekonomike reduktonte pavarësinë e reporterëve dhe kontribuonte në anshmëri në raportime. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë vazhdoi të raportonte vonesa domethënëse në pagesat e rrogave për reporterët në shumicën e organeve të medias. Problemet financiare bënë që disa gazetarë të mbështeteshin më shumë në burime të jashtme të ardhurash.

Ndërkohë që rritja dramatike në median online gjatë vitit shtoi shumëllojshmërinë e pikëpamjeve, OJQ-të besonin se etika profesionale ishte përparësi e ulët për organe të tilla, duke rritur shqetësime mbi përhapjen e lajmeve të rreme që sillnin përfitim për interesa specifike financiare dhe politike.

Në *Indeksin vjetor të Qëndrueshmërisë së Medias*, Bordi Ndërkombëtar për Kërkimet dhe Shkëmbimet (IREX) tregoi se mjedisi mediatik i vendit u përkeqësua në disa fusha. Financimet e donatorëve që nxisnin për shtyp më të pavarur mbetën të kufizuara dhe shtypi ishte i prekshëm nga keqpërdorimi nën presion konstant politik dhe ekonomik. Sipas raportit, shumë pak organe

mediatike prodhuan raportime të pavarura mbi krimin e organizuar sepse gazetarëve të tyre u mungonte pavarësia financiare dhe editoriale.

Pavarësia e Autoritetit të Medias Audiovizive, rregullatori i tregut të medias elektronike, mbeti e dyshimtë, dhe roli i autoritetit mbeti i kufizuar. Shumica e pronarëve të stacioneve televizive përdornin përmbajtjen e transmetimeve të tyre për të ndikuar veprimet e qeverisë ndaj bizneseve të tjera të tyre. Pronarët e bizneseve po ashtu i përdornin lirisht organet e medias për të siguruar favored he promovuar interesat e tyre pranë partive politike.

Dhuna dhe Ngacmimet: Pati raportime për dhunë dhe ngacmime ndaj pjesëtarëve të medias dhe interesat politike dhe të biznesit i ekspozuan gazetarët ndaj presioneve.

Në maj 2016, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë denoncoi rrahjen e rëndë të gazetarit sportive Eduard Illica, sipas pretendimeve për raportimin e sjelljes së dhunshme të një trajneri gjatë një ndeshjeje futbollit. Autoritetet e arrestuan trajnerin, i cili në shkurt u dënua për sulm si nga gjykata e rrethit ashtu dhe ajo e apelit por u lirua për kohën e qëndrimit në paraburgim.

Më 8 mars, dy persona të pidentifikuar sulmuan Elvi Fundon, një gazetar dhe pronar i portalit të lajmeve *citynews.al*, me shufra hekuri, duke shkaktuar plagë të rënda. Policia e hetoi sulmin por deri në shtator nuk i kishte identifikuar autorët. Sipas Fundos, lajmet e portalit të tij ku akuzoheshin pronarë të mediave të tjera për trafik droge dhe disa oficerë policie për korrupsion ishin arsye të mundshme për sulmin.

Censura dhe Kufizimet e Përmbajtjes: Gazetarët shpesh praktikonin vetëcensurë për të shmangur dhunë dhe ngacmime si përgjigje ndaj presioneve të botuesve dhe redaktorëve që synonin të çonin përpara interesat e tyre politike dhe ekonomike. Një sondazh i vitit 2015 nga Rrjeti Ballkanik i Raportimit Investigativ (BIRN) Shqipëri gjeti se kompanitë kryesore komerciale dhe reklamuesit e rëndësishëm ishin burime kryesore të presionit.

Ligjet për Shpifjen: Ligji lejon palët private të bëjnë kallëzim penal dhe të marrin kompensim financiar për fyerje apo botim të qëllimshëm të informacionit fyes. OJQ-të raportuan se gjobat, të cilat mund të shkonin deri në tre milionë lekë (\$26,000), ishin të ekzagjeruara dhe, kombinuar me futjen e dënimit në rekordet penale të të pandehurit, ato minonin lirinë e shprehjes.

Më 9 qershor, një anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Gjin Gjoni, ngriti padi për shpifje kundër dy gazetarëve të BIRN dhe dy gazetarëve të së përditshmes Shqiptarja.com për mbulimin prej tyre të deklaratës së pasurisë së tij, e cila po hetohej nga prokurorët. Gjoni kërkonte shtatë milionë Lekë (\$61,000) nga BIRN dhe katër milionë Lekë (\$35,000) nga Shqiptarja.com, duke pretenduar se artikujt dëmtonin reputacionin e tij.

LIRIA E INTERNETIT

Qeveria nuk kufizoi dhe as ndërpreu aksesin në internet dhe as nuk censuroi përmbajtjen online, dhe nuk pati raportime të besueshme se qeveria monitoronte komunikimet online pa autorizimin e duhur ligjor. Sipas të dhënave nga Internet World Stats të muajit mars, internetin e përdorte rreth 67% e popullsisë.

LIRIA AKADEMIKE DHE AKTIVITETET KULTURORE

Nuk pati kufizime nga qeveria të lirisë akademike apo aktiviteteve kulturore.

b. Liria e Grumbullimit Paqësor dhe Shoqërimit

Kushtetuta dhe ligji sigurojnë liritë e grumbullimit dhe shoqërimit paqësor dhe qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta.

c. Liria e Fesë

Shih *Raportin Ndërkombëtar për Lirinë e Fesë* të Departamentit të Shtetit në adresën: www.state.gov/religiousfreedomreport/.

d. Liria e Lëvizjes

Kushtetuta dhe ligji sigurojnë lirinë e lëvizjes së brendshme, udhëtimit jashtë, emigracionit dhe riatdhesimit dhe qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta.

Qeveria bashkëpunoi me Zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR) dhe organizata të tjera humanitare për të ofruar mbrojtje dhe asistencë për refugjatë, refugjatë të kthyer, azilkërkues, shtetas pa shtetësi dhe persona të tjerë që përbënin shqetësim të ngjashëm. Policia lejoi UNCHR të monitoronte procesimin, ndalimin dhe deportimin e disa migrantëve.

Abuzimi i Migrantëve, Refugjatëve dhe Personave pa Shtetësi: UNHCR raportoi disa raste kur policia frikësonte dhe hezitonte të pranonte kërkesat për azil. Në dy raste, në nëntor 2016 dhe qershor, autoritetet kufitare përdorën forcën kundër grupeve të migrantëve që refuzonin të ktheheshin në Greqi. Pas incidentit të vitit 2016, një migrant i lënduar u hospitalizua dhe UNHCR paraqiti ankesë pranë autoriteteve kufitare.

Autoritetet shpesh ndalonin migrantët e çrregullt që hynin në vend. Deri në nëntor, autoritetet kishin ndaluar afërsisht 744 migrantë, shumica në kufirin jugor të vendit me Greqinë; ata që nuk kërkonin azil përgjithësisht deportoheshin në Greqi brenda 24 orësh. Migrantët e ndaluar më në brendësi të vendit mund të kalonin disa javë në mjedisin e mbyllur të ndalimit të migrantëve në Karrec në pritje të deportimit. Deri në nëntor, qeveria raportoi katër persona të ndaluar në qendrën Karrec.

UNHCR raportoi se afërsisht 30 përqind e migrantëve kërkuan azil. Disa OJQ dhe UNHCR pohuan se edhe disa migrantë që kërkuan azil ishin deportuar. UNHCR paraqiti ankesa formale pranë qeverisë, por autoritetet përgjithësisht ishin të ngadalta në trajtimin e tyre. UNHCR raportoi se kushtet në qendrën Karrec ishin të papërdorshme, sidomos për fëmijët. Deri në shtator, qeveria kishte referuar më pak migrantë për në Karrec krahasuar me vitin 2016 dhe vetëm një minoren – një djalë 17-vjeçar që udhëtonte në grup – kaloi kohë aty.

Lëvizjet Brenda Vendit: Për të marrë shërbimet e qeverisë, individët që ndryshojnë vendbanimin brenda vendit duhet të transferojnë regjistrimin civil në komunitetin e rid he të provojnë ligjshmërinë e vendbanimit të ri nëpërmjet pronësisë, marrëveshjes së qerasë, apo faturave të utiliteteve. Shumë persona nuk ofronin dot prova dhe për pasojë iu mungonte aksesi në shërbimet publike. Shtetas të tjerëve, sidomos romëve dhe egjiptianëve ballkanikë, iu mungonte

regjistrimi formal në komunitetet ku banonin. Ligji nuk e ndalon regjistrimin e tyre, por shpesh ishte i vështirë të përmbushej. Shumë romëve dhe ballkano-egjiptianëve iu mungonin mjetet financiare për t'u regjistruar dhe shumë prej tyre iu mungonte motivimi për ta çuar procesin deri në fund.

MBROJTJA E REFUGJATËVE

Akresi në Azil: Ligji siguron dhënien e azilit ose statusit të refugjatit dhe qeveria ka ngritur një sistem për t'iu ofruar mbrojtje refugjatëve.

Pati raportime të besueshme nga OJQ-të dhe migrantët dhe azilkërkuesit se autoritetet nuk i ndiqnin detyrimet e procesit për disa azilkërkues dhe në raste të tjera ata që kërkonin azil nuk kishin akses në sistem. Deri në nëntor, 744 migrantë – shumica algjerianë, sirianë dhe libianë – kishin hyrë në vend, shumica nëpërmjet kufirit jugor të vendit me Greqinë. Nga këta, 128 kërkuan azil. Autoritetet kthyen ata që nuk kërkuan azil në Greqi, disa menjëherë dhe disa të tjera pas disa javësh ndalim në mjedise të papërshtatshme. UNHCR ishte kritike ndaj procedurave të qeverisë për kontrollin dhe ndalimin e migrantëve, sidomos për sa i përket pranisë së rritur të fëmijëve mes migrantëve.

Ligji për azilin kërkon që autoritetet të akordojnë ose mohojnë azilin brenda 51 ditësh nga kërkesa fillestare e aplikantit. Sipas ligjit, azilkërkuesit nuk mund të përballen me akuza penale nëse kontaktojnë autoritetet brenda 10 ditësh nga mbërritja e tyre në vend. UNHCR raportoi se sistemit të azilit i mungonte monitorimi i efektshëm. Në mars, autoritetet kthyen një grua algjeriane në Greqi edhe pse kishte kërkuar azil; autoritetet po ashtu kthyen një minoren pakistaneze të pashoqëruar pa treguar ndonjë konsideratë të posaçme për moshën e tij. UNHCR shprehu shqetësim për mekanizmin e qeverisë për apelimet e kërkesave të refuzuara për azil meqenëse organit të apelit përgjithësisht i mungonte ekspertiza dhe kishte prirjen të konfirmonte vendimet fillestare pa marrë në shqyrtim thelbin e çështjes.

Vendi i Sigurt i Origjinës/Tranzitit: Ligji ndalon individët nga vendet e sigurta të origjinës/tranzitit që të aplikojnë për azil apo status refugjati. Megjithatë, UNHCR raportoi se nuk kishte kërkesa për azil të refuzuara gbazuar në listën e qeverisë për vendet e sigurta, e cila përfshin Greqinë.

Punësimi: Ligji lejon refugjatët të kenë akses në punë. Megjithatë, lëshimi i kufizuar i kartave të identifikimit dhe lejeve të punës për refugjatët nënkuptonte se pak refugjatë arrinin të punonin faktikisht.

Akses në Shërbimet Bazë: Ligji iu ofron migrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve akses në shërbimet publike, përfshi arsim, kujdes shëndetësor, strehim, ligjzbatim, procedura gjykatash/gjyqësore, dhe asistencë ligjore. Migrantët dhe azilkërkuesit shpesh kërkonin ndërhyrjen e UNHCR-së apo OJQ-ve lokale për t'i siguruar këto shërbime.

Zgjidhjet Afatgjata: Në shtator 2016, qeveria përmbylli procesin e marrjes së refugjatëve Iranianë Mujahideen-e Khalq dhe vazhdoi të lehtësonte integrimin e tyre vendor gjatë gjithë vitit.

PERSONAT PA SHTETËSI

Qeveria nuk kishte informacion të përditësuar lidhur me numrin total të personave në rrezik pashtetësie. Duke përdorur të dhëna nga rastet që ishin zgjidhur nga viti 2011 deri në 2016 me ndihmën e OJQ-së Tirana Legal Aid Society, UNHCR përllogariti se numri ishte 4,871, më i ulët se 7,433 personat që ishin deklaruar si të paregjistruar gjatë censusit të vitit 2011. Shumica e këtyre ishin fëmijë romë apo ballkano-egjiptianë. Rreziku i pashtetësisë vazhdoi të ekzistonte për fëmijë të paregjistruar të lindur jashtë pranë familjeve të kthyera migrante, edhe pse ligji jep mundësinë për të siguruar kombësinë.

SEKSIONI 3. LIRIA PËR TË MARRË PJESË NË PROCESIN POLITIK

Kushtetuta dhe ligji iu sigurojnë qytetarëve aftësinë për të zgjedhur qeverinë e tyre në zgjedhje të lira dhe të ndershme periodike, zhvilluar me votë të fshehtë mbi bazën e të drejtës universale dhe të barabartë të votës.

Zgjedhjet dhe Pjesëmarrja Politike

Zgjedhjet e Fundit: Zgjedhjet më të fundit komobëtare parlamentare u zhvilluan më 25 qershor. Misioni vëzhgues i OSBE-së për zgjedhjet raportoi, “garuesit ishin në gjendje të bënin fushatë lirisht dhe liritë themelore u respektuan.” OSBE më tej vërejti, “Politizimi i vazhdueshëm i organeve dhe institucioneve të lidhura me zgjedhjet si dhe pretendimet e përhapura gjerësisht për blerje votash dhe presion ndaj votuesve zbehën besimin publik në procesin zgjedhor.” Lidhur me vetë votimin, misioni i OSBE-së vërejti “një ditë votimi përgjithësisht të rregullt” por gjeti se “procedura të rëndësishme nuk u respektuan plotësisht në një numër të konsiderueshëm qendrash votimi të vëzhguara.”

Pjesëmarrja e Grave dhe Pakicave: Nuk ka ligj që kufizon pjesëmarrjen e grave dhe/ose anëtarëve të pakicave në procesin politik dhe faktikisht morën pjesë. Si rezultat i zgjedhjeve të 25 qershorit, pjesëmarrja e grave në qeverisje u rrit në shifrën rekord prej 29 përqind anëtarë të kuvendit femra dhe 47 përqind ministre femra. Ligji që rregullon zgjedhjet e kuvendit kërkon që 30 përqind e kandidatëve të jenë femra dhe që ato të zënë 30 përqind të posteve të emëruara dhe të zgjedhura. Megjithatë, sipas raportit paraprak të OSBE-së partitë më të mëdha nuk e respektuan gjithmonë kuotën e detyrueshme prej 30 përqind në listat e kandidatëve të tyre. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i gjobiti këto parti por prapëseprapë i pranoi listat e tyre.

Anëtarë të pakicave kombëtare ishin kandidatë si në partitë e pakicave ashtu dhe ato kryesore, dhe zhvillimi i fushatës si në gjuhët greke ashtu edhe maqedonase u vëzhgua si pa incidente. Megjithatë, vëzhguesit raportuan se romët ishin të prekshëm nga blerja e votive. Deri në shtator, nuk kishte ministra apo anëtarë romë në kuvend.

SEKSIONI 4. KORRUPSIONI DHE MUNGESA E TRANSPARENCËS NË QEVERISJE

Ligji siguron ndëshkime penale për korrupsion nga zyrtarët publikë, por qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë të efektshme, dhe zyrtarët shpesh u përfshinë në praktika korruptive pa u ndëshkuar. Ligji ndalon individët me dënime penale që të shërbejnë si kryebashkiakë, deputetë apo në poste qeveritare a shtetërore.

Gjatë vitit, autoritetet ndërmorën hapa shtesë për të luftuar korrupsionin. Duke filluar në shkurt, anëtarët e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, përbërë nga ekspertë gjyqësorë

ndërkombëtarë, filluan të ndihmonin qeverinë për ngritjen e institucioneve të reja antikorrupsion, dhe deri në korrik, kuvendi kishte emëruar të gjithë anëtarët e komisioneve të vetingut në nivelin e parë dhe të apelit, si dhe komisionerët publikë. Më 30 tetor, komisionet e vetingut shpallën publikisht fillimin e punës së tyre.

Një numër agjencish qeveritare hetonin rastet e korrupsionit, por burimet e kufizuara, rrjedhjet hetimore, presioni real dhe i perceptuar politik, si dhe një sistem rrimërimi i çrregullt penguan hetimet. Në raste selektive ku përfshiheshin aktorë ndërkombëtarë, agjencitë antikorrupsion bashkëpunuan me shoqërinë civile.

Korrupsioni: Korrupsioni ishte i përhapur në të gjitha degët e qeverisjes. Midis janarit dhe gushtit, zyra e prokurorit të përgjithshëm regjistroi 182 hetime të reja për korrupsion. Gjatë së njëjtës periudhë, 122 persona dolën në gjyq për kundravajtje korrupsioni dhe 99 përqind u dënuan. Deri në gusht, 17,752 ankesa ishin paraqitur nëpërmjet portalit online *stopkorrupsion.al*, rreth 8 përqind e të cilave përmbanin informacion lidhur me praktika të pretenduara korruptive. Në tetor, prokurorët shpallën hetimin e një ish-ministri të brendshëm për lidhje me krimin e organizuar dhe abuzim me detyrën.

Ndërkohë që prokurorët bënë përparim domethënës në ndjekjen e rasteve të korrupsionit publik të nivelit të ulët, përfshi prokurorë dhe gjyqtarë të korruptuar, ndjekja penale e krimeve të nivelit të lartë mbeti e paprekshme si pasojë e frikës së hetuesve nga ndëshkimet, mungesa e përgjithshme e burimeve, dhe korrupsioni brenda vetë gjyqësorit. Gjatë periudhës 2016-2017, gjykata e shkallës së parë për krimet e rënda dënoi tre gjyqtarë, dy prokurorë dhe një zyrtar të nivelit të lartë për korrupsion. Kryetari i Bashkisë Dibër, Shukri Xhelili, u dënuar me dy vjet e tetë muaj pas transmetimit të një videoje në të cilën shfaqej teksa kërkonte favore seksuale nga një femër në shkëmbim të një vendi pune. Në maj, gjykata e apelit e krimeve të rënda e ndryshoi vendimin, duke e dënuar Xhelilin për marrëdhënie seksuale në abuzim të detyrës dhe duke e shkurtuar dënimin e tij me një vit.

Deklarimi Financiar: Ligji iu kërkon zyrtarëve publikë që të deklarojnë pasuritë e tyre pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesit (ILDKPKI), i cili monitoronte dhe verifikonte këto deklarime dhe ia vinte në dispozicion publikut. Ligji e autorizon ILDKPKI që të gjosisë zyrtarët që nuk përmbushin kërkesat për deklarimin ose t'ia referojnë ata prokurorisë.

Deri në gusht, ILDKPKI kishte gjobitur 426 individë për mosdeklarim të pasurive, konflikt interesi, apo shkelje të ligjit për mbrojtjen e bilbilfryrësve. ILDKPKI raportoi se deri në gusht, kishte referuar 31 raste të reja në prokurori, ku përfshiheshin gjashtë deputetë, një zëvendës-ministër, një kryetar bashkie, gjashtë inspektorë taksash, gjashtë zyrtarë dogane, dhe 11 zyrtarë të tjerë qeveritarë për akuza të refuzimit të deklarimit, fshehjes, apo falsifikimit të deklaratave të pasurisë, pastrim parash, falsifikim dokumentesh dhe korrupsion.

SEKSIONI 5. QËNDRIMI QEVERTAR NË LIDHJE ME HETIMIN NDËRKOMBËTAR DHE JOQEVERTAR TË DYSHIMEVE PËR SHKELJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Një numër grupesh vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut vepruan në përgjithësi pa kufizim nga ana e qeverisë, duke hetuar dhe botuar gjetjet e tyre mbi rastet e të drejtave të

njeriut. Zyrtarët qeveritarë përgjithësisht ishin bashkëpunues dhe reagues ndaj këndvështrimeve të tyre.

Organizma Qeveritare të të Drejtave Të Njeriut: Zyra e Avokatit të Popullit është institucioni kryesor për promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut. Institucioni i Avokatit të Popullit autorizohet nga ligjit të monitorojë dhe raportojë mbi burgjet dhe qendrat e paraburgimit. Kjo zyrë mund të hapë hetime bazuar në ankesa ose në raste kur viktimat nuk mundet të dalë vetë publikisht. Megjithëse Avokati i Popullit nuk kishte fuqinë të zbatonte vendimet, ai veprroi si monitorues për shkeljet e të drejtave të njeriut. Zyra e Avokatit të Popullit kishte mungesa në fonde dhe në personel.

Kuvendi ka një komision parlamentar për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, i cili shqyrton raportin vjetor të Zyrës së Avokatit të Popullit. Komisioni ishte i angazhuar dhe efikas në çështjet legjislative.

SEKSIONI 6. DISKRIMINIMI, ABUZIMET SHOQËRORE DHE TRAFIKIMI I PERSONAVE

Gratë

Përdhunimi dhe dhuna në familje: Përdhunimi, përfshirë përdhunimin bashkëshortor, është krim. Ndëshkimet për përdhunim dhe ngacmim varen nga mosha e viktimës. Për përdhunimin e një të rrituri dënimi me burg është nga tre deri në 10 vjet. Ligji përfshin dispozita mbi sulmin seksual dhe ngacmimin seksual dhe qartëson kriminalizimin e përdhunimit bashkëshortor. Qeveria nuk e zbatoi me efikasitet ligjin. Zyrtarët nuk e ndoqën penalisht përdhunimin bashkëshortor. Koncepti i përdhunimit bashkëshortor nuk ishte i kuptuar drejt, dhe autoritetet shpesh nuk e konsideruan atë si krim.

Dhuna në familje kundër grave mbeti problem serioz. Policia shpesh nuk kishte trajnimin ose kapacitetin për të shqyrtuar si duhet rastet e dhunës në familje. Qeveria operoi tre streha për mbrojtjen e të mbijetuarve të dhunës në familje ndërsa OJQ-të drejtuan gjashtë të tilla.

Ngacmimi Seksual: Ligji ndalon ngacmimin seksual, megjithëse zyrtarët rrallë e zbatuan atë. Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi në përgjithësi shqyrtoi raste të ngacmimit seksual dhe mund të vendosë gjoba deri në 80,000 lekë (\$700) kundër individëve ose deri në 600,000 lekë (\$5,300) kundër ndërmarrjeve.

Shtrëngimi në Kontrollin të Popullsisë: Nuk pati raporte abortimi të detyruar, sterilizim të pavullnetshëm apo të mënyrave të tjera shtrënguese të kontrollit të popullsisë. Shifra të përafërta mbi vdekshmërinë foshnjore dhe mbizotërimin e kontraceptivëve mund të gjenden në: www.who.int/reproductivehealth/publications/monitoring/maternal-mortality-2015/en/.

Diskriminimi: Ligji garanton status të njëjtë ligjor dhe të drejta të barabarta si për gratë dhe për burrat. Gratë nuk ishin të përfaqësuara mirë në nivelet më të larta të shumë fushave. Ligji dikton pagesë të barabartë për punë të barabartë, megjithëse shumë punëdhënës privatë nuk e zbatuan plotësisht këtë dispozitë. Në shumë komunitete gratë përjetuan diskriminim social bazuar në normat tradicionale sociale që i përshkruajnë gratë si të nënshtruara ndaj burrave. Pati raportime për diskriminim në punësim.

Përzgjedhja e Fëmijës Bazuar mbi Parapëlqimin Gjinator: Sipas agjencisë statistikore të qeverisë, raporti djem-vajza në lindje në vitin 2016 ishte 107 me 100, gjë që tregon se mund të ketë përzgjedhje të seksit të fëmijët bazuar tek parapëlqimi gjinator. Qeveria nuk mbështeti përpjekjet për të shqyrtuar mungesën e ekulibrit gjinator.

Fëmijët

Regjistrimi i Lindjes: Individu merr nënshtetësinë me lindjen brenda territorit të vendit ose duke patur njërin prej prindërve nënshtetas. Nuk pati raportime për diskriminim në regjistrimin e lindjes, por kërkesat rënduese për provën e rezidencës dhe banesës për regjistrim e bënë të vështirë atë për shumë prindër romë dhe egjiptiano-ballkanas të cilët nuk kishin dokumentacion ligjor për vendbanimet që të regjistronin fëmijët e tyre.

Fëmijët e lindur nga migrantë të brendshëm, përfshirë disa familje Rome, ose nga ata që janë kthyer nga jashtë shtetit, shpesh nuk kishin certificate lindjeje ose dokumentacion tjetër të ligjshëm lindjeje dhe si rrjedhojë nuk mund të ndiqnin shkollën ose të përfitonin shërbime të tjera.

Arsimi: Ndjekja e shkollës është e detyrueshme deri në klasën e nëntë ose deri në moshën 16 vjeç, cilado vjen e para, por shumë fëmijë, veçanërisht në zona rurale, lanë shkollën më parë për të punuar me familjet e tyre. Prindërit duhet të blejnë mjetet shkollore, librat, uniformat dhe ngrohësit për disa klase; këto ishin të shtrenjta dhe të pamundura për shumë familje, veçanërisht familjet rome dhe pakica të tjera. Shumë familje gjithashtu përmendën këto kosto për mosdërgimin e vajzave në shkollë.

Abuzimi me fëmijët: Vëshguesit besonin se abuzimi me fëmijët ishte rritur, sidomos në shkolla.

Qendrat për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki raportuan 104 raste dhune fizike ndaj fëmijëve për 2016.

Martesa e Hershme dhe me Detyrim: Megjithëse minimumi i ligjshëm për martesë është 18 vjeç, autoritetet nuk e zbatuan ligjin në çdo rast. Martesat nën moshë ndodhën më së shumti në zonat rurale dhe në bashkësitë rome. Sipas të dhënave të publikuara nga Instituti Shqiptar i Statistikave, numri i martesave të hershme (nën moshën 19 vjeç) në 2016 u ul ndjeshëm nga viti 2015.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Dënimet për shfrytëzimin në tregëti seksi të fëmijëve variojnë nga tetë deri në 15 vjet burg. Vendi ka një ligj që dënon përdhunimin, dhe mosha minimale për marrëdhënie seksuale me dëshirë është 14 vjeç. Dënimi i parashikuar me ligj për përdhunimin është burgim nga pesë deri në 15 vjet. Ligji ndalon prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë me fëmijë; dënimet janë burgim nga tre deri në 10 vjet. Zotërimi i pornografisë së fëmijëve është i paligjshëm.

Autoritetet në përgjithësi zbatuan me efikasitet ligjet kundër përdhunimit dhe shfrytëzimit seksual të minorenëve, por OJQ-të raportuan se ligjet që ndalonin pornografinë me fëmijë rrallë u vunë në zbatim. Qeveria raportoi se, deri në korrik, gjashtë fëmijë ishin shfrytëzuar

seksualisht, por nuk kishte asnjë rast që përfshinte pornografinë. Deri në tetor, u identifikuan 39 fëmijë të cilët ishin viktime të trafikimit ose viktime të mundshëm të trafikimit.

Fëmijët e Zhvendosur: Vazhdoi të kishte shumë fëmijë të zhvendosur dhe fëmijë në rrugë, veçanërisht nga bashkësitë rome. Fëmijët e rrugës lypnin ose bënin punë të vogla. Këta fëmijë ishin më të rrezikuarit nga trafikimi dhe disa prej tyre ranë viktime të trafikimit. Duke qenë se ligji ndalon procedimin penal të fëmijëve nën moshën 14 vjeç për vjedhje shtëpish, bandat kriminale herë pas here përdornin fëmijët e zhvendosur për të plaçkitur shtëpi.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve raportoi se deri në qershor, autoritetet kishin ndihmuar 441 fëmijë të cilët ndodheshin në kushtet e rrugës. 64 prej tyre u dorëzuan pranë strehave ndërsa 15 të tjerë iu referuan prokurorëve pasi ishin keqtrajtuar.

Fëmijët në Institucione Përkujdesjeje: Njësia e mbajtjes së fëmijëve migrantë në Karrec u konsiderua e papërshtatshme për fëmijë. Qeveria bëri përpjekje për të shmangur dërgimin e fëmijëve aty.

Rrëmbime Ndërkombëtare të Fëmijëve: Vendi është palë e Konventës së Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimeve Ndërkombëtare të Fëmijëve, e vitit 1980. Shih Raportin Vjetor për Rrëmbimin Ndërkombëtar Prindëror të Fëmijëve të Departamentit të Shtetit në adresën: travel.state.gov/content/childabduction/en/legal/compliance.html

Anti-Semitizmi

Sipas raportimeve, vetëm disa qindra hebrenj jetonin në vend. Nuk pati raportime për akte anti-semitike.

Trafikimi i Personave

Shih Raportin për Trafikimin e Personave të Departamentit të Shtetit në adresën: www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

Personat me Paaftësi

Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë diskriminimin kundër personave me paaftësi fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore. Megjithatë, punëdhënësit, shkollat, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe ofrues të shërbimeve të tjera shtetërore ndonjëherë kryenin diskriminim. Ligji detyron që ndërtesat e reja publike të jenë të aksesueshme për personat me paaftësi, por qeveria e zbatoi ligjin vetëm në raste sporadike. Përgjatë vitit, qeveria përshtati ndërtesat e tetë shkollave për të lehtësuar personat me paaftësi dhe tetë të tjera ishin në ndërtim e sipër.

Qeveria sponsorizoi agjenci të shërbimeve sociale për të mbrojtur të drejtat e personave me paaftësi, por këto agjenci zakonisht kishin mungesa financimi për të vënë në zbatim programet e tyre. Kufizimet në burime dhe mungesa e infrastrukturës e bënin të vështirë që personat me paaftësi të merrnin pjesë plotësisht në çështje civile. Qendrat e votimit shpesh ndodheshin në mjedise që iu mungonin lehtësitë për të tillë persona.

Qeveria hapi dy qendra zhvillimi për personat me paaftësi në Pogradec dhe Bulqizë, mbështetur nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, si dhe tre kopshte për fëmijë me paaftësi në Pogradec, Sarandë dhe Bulqizë.

Avokati i Popullit inspektoi institucionet e shëndetit mendor në mënyrë të rregullt. Si pranimi ashtu edhe nxjerrja e pacientëve në institucione të shëndetit mendor ishin problematike për shkak të vlerësimeve të papërshtatshme psikiatrike. pati diskriminim dhe stigmatizim shoqëror ndaj personave me paaftësi mendore apo të llojeve të tjera.

Pakicat Kombëtare/Racore/Etnike

Pati pretendime për diskriminim ndaj personave të komuniteteve rome dhe egjiptiano-ballkanike, përfshi në strehim, punësim, kujdes shëndetësor dhe arsim. Disa shkolla bënë rezistencë për pranimin e nxënësve romë dhe egjiptiano-ballkanikë, sidomos nëse dukeshin të varfër. Shumë shkolla të përziera që praninin nxënës romë i marginalizonin ata në klasa, herë herës duke i veçuar fizikisht nga nxënësit e tjerë.

OJQ-të për të drejtat e romëve kritikuan Bashkinë e Tiranës për vonesën në ndërtimin e shtëpive të reja për familjet rome, të cilat u hoqën nga banesat e tyre në 2016. Në dhjetor të 2016, bashkia dëboi 76 familje rome nga lagjia e Bregut të Lumit në Tiranë, e cila është e pritur të përmbytet në dimër. 60 prej këtyre familjeve u zhvendosën në një magazinë të përkohshme, ku OJQ-të raportuan se ata jetonin në kushte të tejskajshme, pa higjenë dhe energji elektrike. Bashkia e vonoi zhvendosjen e familjeve në një strehim të përhershëm deri në javën e fundit të dhjetorit.

Në tetor qeveria miratoi një ligj të ri për pakicat. Ligji parashikon statusin zyrtar të pakicave për nëntë pakica kombëtare, pa bërë dallime midis grupeve kombëtare dhe etno-gjuhësore. Qeveria përkufizoi grekët, maqedonasit, arumunët (vllehët), romët, egjiptiano-ballkanikët, malazezët, boshnjakët, serbët dhe bullgarët si pakica kombëtare. Ligji i ri parashikon mësim të gjuhës minoritare dhe përdorim zyrtar të dy gjuhëve në njësitë bashkiake ku këto pakica jetojnë kryesisht, ose në ato njësi ku pakicat përbëjnë 20 përqind të popullsisë së përgjithshme. Pakica etnike greke u ankua për mungesën e vullnetit të qeverisë për të njohur komunitete etnike greke jashtë “zonave minoritare” të kohës së komunizmit.

Akte Dhune, Diskriminimi dhe Abuzime të Tjera Bazuar në Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjnor

Ligji ndalon diskriminimin bazuar në orientimin seksual, përfshi në punësim. Zbatimi i ligjit përgjithësisht ishte i dobët.

Orientimi seksual dhe identiteti gjnor janë ndër grupet e mbrojtura nga ligji I vendit për krimin e urrejtjes. Pavarësisht ligjit dhe mbështetjes formale të qeverisë për të drejtat e personave lezbike, gei, biseksualë, transgjnorë dhe ndërgjnorë (LGBTI), disa herë zyrtarë publikë bënë deklarata homofobike. OJQ-ja Streha raportoi se shumë persona LGBTI përjetuan dhunë në familje për shkak të deklaramit të hapur të orientimit të tyre seksual.

Deri në gusht, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori tre ankesa të cilat pretendonin për diskriminim bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor përgjatë vitit. Komisioni votoi në favor në një prej rasteve.

Stigma Shoqërore ndaj HIV dhe SIDA

Ligji ndalon diskriminimin kundër personave me HIV/SIDA. Shoqata shqiptare e Njerëzve me HIV/SIDA raportoi se diskriminimi dhe stigmatizimi i njerëzve me HIV/SIDA ishte gjerësisht i përhapur në vend.

Dhunë ose Diskriminim Tjetër nga Shoqëria

Përgjatë vitit ndodhën incidente të vrasjeve shoqërore, përfshi vrasjet për gjakmarrje dhe ato për hakmarrje, por deri në gusht autoritetet raportuan vetëm një rast vrasjeje për gjakmarrje. Avokati i Popullit raportoi se përpjekjet e autoriteteve për të mbrojtur familjet apo parandaluar vrasjet nga gjakmarrja ishin të pamjaftueshme, edhe pse qeveria i rriti përpjekjet për t'i ndjekur penalisht të tilla krime.

SEKSIONI 7. TË DREJTAT E PUNËTORËVE

a. Liria e grupimit në shoqata dhe e drejta për marrëveshje kolektive

Ligji dhe rregullore e statute të tjera të lidhura me të sigurojnë të drejtën për pjesën më të madhe të punonjësve të formojnë sindikata, të bëjnë greva të ligjshme dhe të bëjnë marrëveshje kolektive. Ligji ndalon diskriminimin kundërsindikatat dhe siguron rikthimin në punë të punonjësve të pushuar për shkak të veprimtarisë në sindikatë.

Ligji ndalon anëtarë të ushtrisë dhe zyrtarë të lartë të qeverisë të bëhen pjesë e sindikatave dhe kërkon që një sindikatë të ketë së paku 20 anëtarë për t'u regjistruar. Ligji garanton të drejtën e grevës për të gjithë punëtorët me përjashtim të personelit të domosdoshëm mjekësor e spitalor, personat që ofrojnë shërbim të kontrollit të trafikut ajror, shërbime në burgje, si dhe zjarrfikësit. Përfshirja në greva ndalohet në "raste të veçanta", si katastrofa natyrore, gjendje lufte, situatë të jashtëzakonshme, dhe raste kur liria e zgjedhjeve është në rrezik. Punonjësit të cilët nuk përjashtohen nga pozicionet e tyre e ushtruan të drejtën e tyre për grevë.

Ligji garatoi mbrojtje të kufizuar ndaj punonjësve shtëpiakë dhe migrantët. Sindikatat e punonjësve ishin kryesisht të dobëta dhe të politizuara. Punonjësit që përfshihen në greva ilegale mund të detyrohen të paguajnë për çdo dëmtim që vjen si pasojë e veprimeve të grevës.

Zbatimi i këtij ligji nga qeveria mbeti gjerësisht jo efektiv, pjesërisht nga përhapja e punësimit informal. Burimet për kryerjen e inspektiveve dhe kompensimin e shkeljeve nuk ishin të mjaftueshme. Gjobat e larta, të cilat sipas ligjit mund të arrijnë në 1.1 milionë lekë (9,600 dollarë) ose deri në pesëdhjetëfish të pagës minimale mujore, rallë u vlerësuan. Masat administrative dhe proceduriale iu nënshtruan vonesave të gjata dhe apelimeve. Procedurat e arbitrazhit lejuan vonesa të mëdha të cilat kufizuan mbrojtjen e punonjësve kundrejt veprimtarisë kundër sindikatës.

Punonjësit civilë në të gjitha fushat kanë të drejtën kushtetuese të organizohen dhe të bëjnë marrëveshje kolektive, dhe ligji përcakton procedura për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve nëpërmjet marrëveshjeve për diskutim kolektiv. Sindikatat që përfaqësonin punonjësit e sektorit publik negociuan në mënyrë të drejtpërdrejtë me qeverinë. Në këtë mjedis, marrëveshjet kolektive edhe kur arriheshin ishin të vështira për t'u zbatuar.

b. Ndalimi i punës me detyrim

Ligji ndalon të gjitha format e punës së detyruar por qeveria nuk e zbatoi gjithmonë me efikasitet këtë ligj. Mungesa e koordinimit mes ministrave dhe natyra sporadike e zbatimit të procedurave standarde të veprimit vështirësuan zbatimin. Dënimet prej tetë deri në 15 vjet në burg ishin mjaftueshëm të ashpra për të frenuar shkeljet. Organizatat e zbatimit të ligjit trajnuan punonjësit e tyre me një qasje me në qendër viktimat e trafikimit njerëzor. Qeveria vazhdoi të identifikonte viktimat trafikimi por ndoqi penalisht dhe dënoi një numër të vogël trafikuesish. Zyra e Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit rriti përpjekjet e qeverisë për të parandaluar trafikimin nëpërmjet aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit.

Pati raste të punës së detyruar gjatë vitit. Fëmijët i nënshtrohen riciklimit të materialeve metalike dhe plastike, punës në miniera, rrobaqepësisë, nxjerrjes në rrugë, agrikulturës dhe blegtorisë. Fëmijët iu nënshtroan lypjes me detyrim dhe aktiviteteve kriminale (shikoni seksionin 7.c.).

Shikoni gjithashtu Raportin mbi Trafikimin e Personave të Departamentit të Shtetit në faqen: www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

c. Ndalimi i punës së të miturve dhe mosha minimale për punësim

Ligji përcakton moshën minimale të punësimit në 16 vjeç, por lejonin fëmijët në moshën 15 vjeç të punësohen në kushte të veçanta kur puna kategorizohet si e "lehtë" dhe nuk pengon shkollën. Në përgjithësi, të gjithë fëmijët nën moshën 18 vjeç mund të punojnë në punë të kategorizuara si "të lehta". Sipas ligjit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale, nën Ministrinë e Rinisë dhe Mirëqënies Sociale, është përgjegjës për fuqizimin e kërkesave të moshës minimale nëpërmjet gjykatave, por Inspektorati Shtetëror i Punës nuk e zbatoi si duhet ligjin. Inspektorët e punës hetuan sektorin e punës formale, ndërkohë që pjesa më e madhe e punës së të miturve kryhej në sektorin informal. Inspektorati Shtetëror i Punës nuk kryen kontrole për punën e minoreneve përveçse kur ka ankesa të caktuara. Pjesa më e madhe e inspektimeve të punës u krye në fabrikat e këpucëve dhe të tekstileve, në call centers dhe në sipërmarrjet me pakicë; zyrtarët gjetën disa raste që përfshinin punë të miturish gjatë inspektimeve të tyre. Dënimet për shkeljet e ligjit rallë u përcaktuan dhe këto nuk ishin të mjaftueshme për të frenuar shkeljet.

Në vitin 2013 agjencia shtetërore e statistikave dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës llogariti 54 000 fëmijë të përfshirë në punë të detyruar në vend. Rreth 43 000 fëmijë punonin në ferma dhe peshkim, 4 400 në sektorin e shërbimeve dhe 2 200 në hotele dhe restorante. Afërsisht 5 përqind e fëmijëve ishin punonjës të mitur.

Ligji kriminalizon shfrytëzimin e fëmijëve për punë dhe shërbime të detyrurara, por qeveria nuk e zbatoi si duhet ligjin. Inspektorati Shtetëror i Punës vëzhgoi raste të punës së minorenëve si dhe shkelje të tjera të ligjit të punës, por burimet e pamjaftueshme njerëzore e kufizuan veprimtarinë e tij. Raportet vërejtën se një pjesë e madhe e punonjësve të mitur punuan si shitës në rrugë ose në dyqane, lypës, fermerë, barinj, kontrabandistë droge, larës makinash, punonjës në fabrika tekstilësh, minierë, ose ilustrues këpucësh. Disa prej fëmijëve që lypin në rrugë ishin brez i dytë ose i tretë lypësish. Kërkimet treguan se lypja niste që në moshën katër ose pesë vjeçare. Ndonëse kodi penal ndalon shfrytëzimin e fëmijëve për lypje, policia në përgjithësi nuk e zbatoi ligjin, megjithëse bëri përpjekje më të mëdha për ta bërë këtë gjatë vitit (shikoni seksionin 6, Fëmijët e zhvendosur).

Organizata Sociale për Mbështetjen e Rinisë raportoi se pjesa më e madhe e fëmijëve që jetonin në kushtet e rrugës ishin djem midis moshës 10 dhe 17 vjeç. Djemtë kryesisht mblidhnin plastikë ose metale për riciklim, dhe në pjesën më të madhe të rasteve punonin të pashoqëruar. World Vision gjithashtu raportoi se fëmijët mblidhnin kanaçe, plastikë dhe metale; punonin në miniera, qepnin këpucë, ose punonin në agrikulturë dhe blegtori. Djem të rinj, pasi mbaronin nivelin minimal arsimor të detyrueshëm nga shteti, shpesh emigronin në vendet fqinje për të mbajtur familjet e tyre. Numri i fëmijëve të përfshirë në aktivitete të lidhura me rrugët (si lypje apo shitje sendesh) u rrit gjatë verës, sidomos në zonat turistike bregdetare.

Sipas Agjencisë Shtetërore për të Drejtat e Fëmijëve, midis korrikut 2016 dhe qershorit, 640 fëmijë në rrugë u përfshinë në lypje, shitje dhe punë informale; 586 prej tyre morën shërbime të rëndësishme. Inspektoriati Shtetëror i Punës raportoi dy raste të shfrytëzimit të të miturve për punë dhe 21 minorenë të tjerë që punonin pa lejen e detyrueshme ligjore apo lejen mjekësore.

Shikoni gjithashtu Të Dhënat mbi Format më të Këqija të Punës së të Miturve të Departamentit të Shtetit në faqen: www.dol.gov/ilab/reports/child-labor/findings/.

d. Diskriminimi në lidhje me punësimin ose zanatin

Ligjet e punës e ndalojnë diskriminimin në punë për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar fizike dhe mendore, bindjeve politike, kombësisë, besimit fetar, familjes, të jetuarit me virusin e SIDA-s dhe origjinës sociale. Diskriminimi në punësim dhe zanat ndodhi në lidhje me gjininë, aftësitë e kufizuara, orientimit seksual dhe identitetit gjinor, kombësisë dhe etnisë. Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi raportoi se arsyet kryesore të diskriminimit të pretenduar ishin raca, gjendja ekonomike, aftësitë e kufizuara, bindjet politike, dhe gjendja shëndetësore.

e. Kushtet e pranueshme të punës

Paga minimale kombëtare duhet të jetë më e lartë se pragu i varfërisë në nivel kombëtar. Inspektorati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin e pagës minimale. Inspektoriati raportoi se kishte 96 inspektorë, një numër i pamjaftueshëm për të zbatuar këtë detyrim.

Ndonëse ligji përcakton javën 40-orëshe të punës, java aktuale e punës përcaktohet me marrëveshje individuale ose kolektive. Ligji përcakton pushime vjetore të paguara, por vetëm punonjësit në tregun formal të punës kishin të drejta për pushime të paguara. Shumë persona

në sektorin privat punuan gjashtë ditë në javë. Ligji kërkon pagesa për orarin shtesë dhe punë gjatë ditëve të pushimit, por punëdhënësit nuk i zbatuan gjithmonë këto përcaktime. Ligji përcakton pagesë shpërblyese për punën jashtë orarit. Qeveria nuk kishte standard për numrin minimal të pushimeve në javë dhe rrallë zbatoi ligje që lidheshin me maksimumin e orëve të punës, kufij në punë jashtë orarit, ose pagesë shpërblyese për punë jashtë orarit, veçanërisht në sektorin privat. Këto ligje nuk zbatoheshin për punonjësit në sektorin informal, si për shembull punonjësit shtëpiakë dhe punonjësit migrantë. Sipas Bankës Botërore, sektori informal përbën pothuajse 50 përqind të të gjithë punësimit në vend.

Inspektorati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe rregulloreve për shëndetin dhe sigurinë profesionale. Mungonte në përgjithësi zbatimi. Kushtet e vendit të punës në prodhim, ndërtim dhe sektorin e minierave shpesh ishin të dobëta dhe në disa raste të rrezikshme. Burimet dhe inspektimet nuk ishin të mjaftueshme dhe dënimet me gjobë shpesh nuk frenuan shkeljet pasi agjencitë e zbatimit të ligjit nuk kishin mjetet për zbatimin e mbledhjes dhe si rrjedhojë rrallë gjobitën shkelësit. Nuk kishte programe qeveritare që të siguronin mbrojtje sociale për punonjësit në ekonominë informale.

Shkeljet e standardeve të sigurisë profesionale ndodhën më shpesh në industrinë e tekstile, të këpucëve, ndërtimit dhe minierave. Punëtorët shpesh nuk mund të dilnin nga situata që rrezikonin shëndetin ose sigurinë e tyre pa rrezikuar punësimin e tyre. Punëdhënësit nuk i mbrojtën efektisht punonjësit në këto situata.